



# **FLETORJA ZYRTARE**

## **E**

### **REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

**Nr. 42**

**2003**

**Maj**

#### **P Ë R M B A J T J A**

|                                       |                                                                                                                                                                                                  | Faqe |
|---------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Dekret nr.3820<br>datë 14.5.2003      | Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....                                                                                                                                                     | 1595 |
| Vendim i KM<br>nr.206, datë 28.3.2003 | Për blerje karburantesh për automjete dhe ngrohje<br>qendrore nga ministritë, institucionet qendrore, buxhetore<br>dhe entet në varësi të tyre me procedurën “Prokurim i<br>drejtpërdrejtë”..... | 1596 |
| Vendim i GJK<br>nr.16, datë 25.4.2003 | Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.1234, datë<br>15.12.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.12, datë<br>10.1.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si<br>antikushtetuese.....       | 1598 |
| Vendim i GJK<br>nr.17, datë 8.5.2003  | Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.142, datë 26.2.2002 të<br>Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si antikushtetues....                                                                         | 1602 |
|                                       | Shpallje kërkesë për shpronësim për ndërtimin e segmentit<br>rrugor Valias-Qerekë-Rinas, si dhe të pronarëve që<br>ndodhen brenda rrethimit të Aeroportit “Nënë Tereza”....                      | 1604 |
|                                       | Shpallje kërkesë për shpronësim publik të pasurive të<br>paluajtshme për rehabilitimin e Urës së Bënçës Tepelenë,<br>në territorin e qarkut Gjirokastrë...                                       | 1606 |

**D E K R E T**  
**Nr.3820, datë 14.5.2003**

**PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik

**D E K R E T O J:**

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- |                                     |                                 |
|-------------------------------------|---------------------------------|
| 1.Besnik Mustafa Xhabafti           | 36.Brunilda Ahmet Shabi (Reka)  |
| 2.Ikbale Avdi Pirker (Ihallko)      | 37.Donika Muhamet Taullah       |
| 3.Marjana Tom Borgas (Curri)        | 38.Liljana Nezir Alliaj (Lusha) |
| 4.Rodolf Dhimitri Adhami            | 39.Mateos Besnik Alliaj         |
| 5.Mirela Ramadan Adhami (Mukollari) | 40.Kristjan Besnik Alliaj       |
| 6.Shkëlqim Hasan Begolli            | 41.Belina Besnik Alliaj         |
| 7.Lindita Ormën Potasznik (Celaj)   | 42.Marsilda Besnik Alliaj       |
| 8. Endri Ylli Mahmutaj              | 43.Agron Daut Dautaj            |
| 9.Helnida Gëzim Manaj               | 44.Renata Agron Dautaj          |
| 10.Kliton Petraq Karamelo           | 45.Vjollca Veli Dautaj (Pashaj) |
| 11.Arben Pipo Spiro                 | 46.Klaudio Agron Dautaj         |
| 12.Agim Nurçe Vezelaj               | 47.Petrit Ahmet Xhakola         |
| 13. Gery Agim Vezelaj               | 48.Patrick Petrit Xhakola       |
| 14.Gentiana Petrit Vezelaj (Dashaj) | 49.Ikbale Jonuz Xhakola (Saraç) |
| 15.Merita Hetem Islamaj (Xhezairaj) | 50.Pren Ndre Saka               |
| 16.Flavia (Flavia) Artur Islamaj    | 51.Regino Pren Saka             |
| 17.Nexhmie Ago Tabaku (Çuni)        | 52.Blerina Basri Hisa           |
| 18.Ramazan Ylli Tabaku              | 53.Vjollca Nazmi Musa (Muka)    |
| 19.Franz Ylli Tabaku                | 54.Erind Refik Musa             |
| 20.Aneta Fatmir Konjuhi (Puka)      | 55.Alban Refik Musa             |
| 21.Kaltrina Shemsi Konjuhi          | 56.Entela Spiro Rama            |
| 22.Ardi Shemsi Konjuhi              | 57.Piro Arben Rama              |
| 23.Vasil Mihal Avrami               | 58.Erwin Arben Rama             |
| 24.Mehmet Skënder Fejzo             | 59.Martin Arben Rama            |
| 25.Daniel Besnik Lamaj              | 60.Esat Ruzvelt Ferra           |
| 26.Ilirian Novrus Meço              | 61.Ilir Esat Ferra              |
| 27.Leonard Ramazan Malaj            | 62.Vilma Simon Karma            |
| 28.Migena Lavdosh Isaj (Ahmeti)     | 63.Albana Petro Gick (Çako)     |
| 29.Artur Eqerem Caslli              | 64.Hajrije Salip Rama (Koçi)    |
| 30.Klodiana Bujar Haumer (Kurila)   | 65.Sabine Adil Rama             |
| 31.Ferdinand Ismail Braimllari      | 66.Ina Adil Rama                |
| 32.Albano Ferdinand Braimllari      | 67.Ornela Adil Rama             |
| 33.Orenela Ferdinand Braimllari     | 68.Ilirian Osman Mane           |
| 34.Fabjola Ferdinand Braimllari     | 69.Feos Ilirian Mane            |
| 35.Mira Feim Braimllari (Dumani)    | 70.Mimoza Fehta Mane (Xhaxhaj)  |
|                                     | 71.Akreona Ilirjan Mane         |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**V E N D I M**  
**Nr.206, datë 28.3.2003**

**PËR BLERJE KARBURANTESH PËR AUTOMJETE DHE NGROHJE QENDRORE NGA  
MINISTRITË, INSTITUCIONET QENDRORE, BUXHETORE DHE ENTET NË VARËSI TË  
TYRE, ME PROCEDURËN “PROKURIM I DREJTPËRDREJTË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3 e 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Blerjen e karburantit për automjete dhe ngrohje qendrore, nga ministritë dhe institucionet qendrore me procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, për periudhën deri më 1 korrik 2003, në shoqëritë “ARMO” sh.a., Fier dhe PETROLIMPEX” sh.a., Tiranë, si më poshtë vijon:

a) Për fondin limit 111 123 471 (njëqind e njëmbëdhjetë milionë e njëqind e njëzet e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një) lekësh, të përdoret procedura “Prokurim i drejtpërdrejtë” me shoqëritë “ARMO” sh.a., Fier dhe “PETROLIMPEX” sh.a., Tiranë për blerje naftë për furnizimin e automjeteve me talona, kundrejt çmimit 88 lekë/litër për naftë vendi dhe 93 lekë/litër për naftë importi.

b) Për fondin limit prej 119 800 200 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milionë e tetëqind mijë e dyqind) lekësh të përdoret procedura “Prokurim i drejtpërdrejtë”, me shoqëritë “ARMO” sh.a., Fier dhe “PETROLIMPEX” sh.a., Tiranë, për blerje naftë për furnizimin e automjeteve dhe ngrohje qendrore, me tërheqje me autobot, kundrejt çmimit 80 lekë/litër për naftë vendi dhe 88 lekë/litër për naftë importi.

c) Për fondin limit prej 26 395 290 (njëzet e gjashtë milionë e treqind e nëndhjetë e pesë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekësh, të përdoret procedura “Prokurim i drejtpërdrejtë”, me shoqërinë “ARMO” sh.a., Fier, për blerje solari për ngrohje qendrore, kundrejt çmimit 30 lekë/litër.

ç) Për fondin limit prej 31 954 140 (tridhjetë e një milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e dyzet) lekësh, të përdoret procedura “Prokurim i drejtpërdrejtë”, me shoqërinë “PETROLIMPEX” sh.a., Tiranë, për blerje benzine pa plumb, për furnizimin e automjeteve me talona, kundrejt çmimit 113 lekë/litër.

d) Për fondin limit prej 70 513 500 (shtatëdhjetë milionë e pesëqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind) lekësh, të përdoret procedura “Prokurim i drejtpërdrejtë”, me shoqërinë “PETROLIMPEX”, sh.a., Tiranë, për blerje benzine pa plumb me tërheqje me autobot, kundrejt çmimit 105 lekë/litër.

dh) Për fondin limit prej 3 586 104 (tre milionë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e katër) lekësh, të përdoret procedura “Prokurim i drejtpërdrejtë”, me shoqërinë “PETROLIMPEX”, sh.a., Tiranë, për blerje benzine super për furnizimin e automjeteve me talona, kundrejt çmimit 108 lekë/litër.

2. Ministritë, institucionet qendrore, buxhetore dhe entet e varësisë të lidhin kontratat përkatëse, për fondet sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Zbatimi i paragrafëve të pikës 6.2 të vendimit nr.676, datë 20.12.2002 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondeve buxhetore të planifikuara për mallra, shërbime, ndërtime”, për shërbimet për furnizim me karburant, gazoil, benzol dhe për ngrohje qendrore, të pezullohet për periudhën deri më 1 korrik 2003.

4. Ngarkohen ministritë dhe institucionet qendrore, buxhetore, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Fatos Nano**

**REGJISTRI I PARASHIKIMIT TË PROKURIMEVE PUBLIKE PËR KARBURANTE**

|    | Objekti i prokurimit dhe Institutcionet Qendrore     | Fondi limit i parashikuar për gazoilin, tollona | Fondi limit i parashikuar për benzinë super, tollona | Fondi limit i parashikuar për benzinë pa plumb, tollona | Fondi i parashikuar për gazoil lëng | Fondi i parashikuar për benzinë pa plumb, lëng | Fondi i parashikuar për solar | Fondi total    |
|----|------------------------------------------------------|-------------------------------------------------|------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------|-------------------------------------|------------------------------------------------|-------------------------------|----------------|
| 1  | Ministria e Mbrojtjes                                | 2,772,000                                       | 0                                                    | 1,890,000                                               | 52,668,000                          | 17,010,000                                     | 0                             | 363,372,705.00 |
| 2  | Blerje karburanti Qendra Kombëtare e Kinematografisë | 120,000                                         | 0                                                    | 0                                                       | 0                                   | 0                                              | 0                             |                |
| 3  | Blerje karburanti Avokati i Popullit                 | 832,500                                         | 0                                                    | 198,000                                                 | 0                                   | 0                                              | 0                             |                |
| 4  | Instituti i të Përndjekurve Politikë                 | 259,200                                         | 0                                                    | 0                                                       | 0                                   | 0                                              | 0                             |                |
| 5  | Agjencia Telegrafike Shqiptare                       | 648,000                                         | 0                                                    | 348,000                                                 | 0                                   | 0                                              | 0                             |                |
| 6  | Shkolla e Magjistraturës                             | 360,000                                         | 0                                                    | 0                                                       | 0                                   | 0                                              | 0                             |                |
| 7  | Ministria e Transporteve dhe e Telekomunikacionit    | 1,155,000                                       | 0                                                    | 855,000                                                 | 0                                   | 0                                              | 0                             |                |
| 8  | Ministria e Punëve të Jashtme                        | 1,890,000                                       | 0                                                    | 1,950,000                                               | 0                                   | 0                                              | 0                             |                |
| 9  | Blerje karburanti Ministria e Drejtësisë             | 5,055,000                                       | 0                                                    | 2,613,000                                               | 0                                   | 0                                              | 0                             |                |
| 10 | Ministria e Rendit Publik                            | 0                                               | 0                                                    | 0                                                       | 51,900,000                          | 46,800,000                                     | 0                             |                |
| 11 | Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm                    | 6,830,721                                       | 172,104                                              | 1,650,780                                               | 0                                   | 0                                              | 0                             |                |
| 12 | Agjencia e Prokurimit Publik                         | 180,000                                         | 0                                                    | 90,000                                                  | 0                                   | 0                                              | 0                             |                |
| 13 | Garda e Republikës                                   | 3,900,000                                       | 0                                                    | 4,800,000                                               | 0                                   | 0                                              | 0                             |                |
| 14 | Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit     | 1,260,000                                       | 0                                                    | 360,000                                                 | 0                                   | 0                                              | 0                             |                |
| 15 | Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale              | 4,053,240                                       | 0                                                    | 2,702,160                                               | 0                                   | 0                                              | 0                             |                |
| 16 | Ministria e Ekonomisë                                | 1,320,510                                       | 0                                                    | 427,500                                                 | 681,000                             | 0                                              | 548790                        |                |
| 17 | Drejtoria Rajonale Rrugore                           | 11,715,000                                      | 0                                                    | 0                                                       | 0                                   | 0                                              | 0                             |                |
| 18 | Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit                | 201,600                                         | 0                                                    | 0                                                       | 0                                   | 0                                              | 0                             |                |
| 19 | Ministria e Shëndetësisë                             | 16,680,000                                      | 0                                                    | 0                                                       | 1,020,000                           | 4,440,000                                      | 23670000                      |                |
| 20 | Ministria e Mjedisit                                 | 1,200,000                                       | 0                                                    | 855,000                                                 | 0                                   | 0                                              | 0                             |                |
| 21 | Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit     | 9,291,300                                       | 2,250,000                                            | 0                                                       | 0                                   | 0                                              | 0                             |                |

|    |                                                      |             |           |            |             |            |            |  |
|----|------------------------------------------------------|-------------|-----------|------------|-------------|------------|------------|--|
| 22 | Ministria e Financave                                | 630,000     | 0         | 1,125,000  | 585,000     | 0          | 0          |  |
| 23 | Këshilli i Ministrave, Komiteti i Birësimeve         | 1,950,000   | 0         | 3,780,000  | 0           | 0          | 0          |  |
| 24 | Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës            | 4,172,700   | 0         | 1,603,200  | 0           | 0          | 0          |  |
| 25 | Ministria e Kulturës Rinisë dhe e Sporteve           | 1,515,000   | 0         | 1,140,000  | 0           | 0          | 189 000    |  |
| 26 | Shërbimi Informativ Shtetëror                        | 1,796,400   | 0         | 1,939,800  | 2,015,700   | 1,603,500  | 0          |  |
| 27 | Akademia e Shkencave                                 | 1,339,800   | 0         | 812,700    | 0           | 0          | 60 000     |  |
| 28 | Ndërmarrja e trajtimit të studentëve nr.2            | 210,000     | 0         | 0          | 0           | 0          | 750 000    |  |
| 29 | Ministria e Bujqësisë                                | 1,620,000   | 0         | 180,000    | 0           | 0          | 0          |  |
| 30 | Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit | 2,625,000   | 0         | 1,530,000  | 0           | 0          | 0          |  |
| 31 | Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve                  | 9,720,000   | 0         | 780,000    | 0           | 0          | 0          |  |
| 32 | Avokatura e Shtetit                                  | 180,000     | 0         | 120,000    | 0           | 0          | 0          |  |
| 33 | Ministria e Arsimit                                  | 6,930,000   | 717,000   | 204,000    | 0           | 0          | 1 177 500  |  |
| 34 | Drejtorja e Përgjithshme e Doganave                  | 8,710,500   | 447,000   | 0          | 10,930,500  | 660,000    | 0          |  |
| 35 |                                                      |             |           |            |             |            |            |  |
| 36 |                                                      |             |           |            |             |            |            |  |
|    | Shuma totale                                         | 111,123,471 | 3,586,104 | 31,954,140 | 119,800,200 | 70,513,500 | 26 395 290 |  |

Totali i shumave 363 372 705

**V E N D I M**  
**Nr.16, datë 25.4.2003**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu Kryetar i Gjykatës Kushtetuese  
Zija Vuci Anëtar i“““  
Gjergj Sauli Anëtar i“““  
Alfred Karamuço Anëtar i“““  
Kristofor Peçi Anëtar i“““  
Petrit Plloçi Anëtar i“““  
Sokol Sadushi Anëtar i“““  
Xhezair Zaganjori Anëtar i“““

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 24.2.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me

dher të hapura çështjen me nr.14 Akti, që i përket:

KËRKUES: AGRON VRETO, përfaqësuar nga avokate Hanëme Bakia, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. SOKOL MARA, përfaqësuar nga avokat Dashmir Kore, me prokurë.
2. SUZANA MARA, përfaqësuar nga avokat Dashmir Kore, me prokurë.
3. NDËRMARRJA KOMUNALE BANESA NR.2 TIRANË, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese i vendimeve nr.1234, datë 15.12.2000 të

Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.12, datë 10.1.2002 të Kolegjit Civil të

Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f, 134/g, 41/1 e 42 të Kushtetutës së Republikës të

Shqipërisë.

Për shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve të mësipërme, kërkuesi Agron Vreto ka parashtruar përpara Gjykatës Kushtetuese këto shkaqe:

- Në përbërje të trupit gjykues të Gjykatës së Lartë që e ka shqyrtuar çështjen në Dhomën e Këshillimit, në kundërshtim me nenin 72/4 të Kodit të Procedurës Civile, ka marrë pjesë edhe një gjyqtar, i cili në gjykimin e mëparshëm të po kësaj çështjeje në Gjykatën e Lartë është shprehur me “mendim pakice”;

- Gjykata e apelit nuk ka respektuar detyrat e vëna për këtë çështje nga Gjykata e Lartë, duke shkelur kështu nenin 486 të Kodit të Procedurës Civile;

- Vendimi i gjykatës së apelit është në kundërshtim me ligjin material;

- Rekursi i ushtruar ka qenë brenda kriterëve ligjore, prandaj vendimi i Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë për moskalimin e çështjes për gjykim është në kundërshtim me pikat “a” dhe “b” të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile.

#### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Xhezair Zaganjori, përfaqësuesen e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

#### V Ë R E N:

Me vendimin nr.115, datë 19.4.2002 Gjykata Kushtetuese ka vendosur refuzimin e kërkesës së kërkuesit Agron Vreto për shkak se në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje nuk u bë e mundur të votohej për zgjidhjen e saj përfundimtare. Në bazë të nenit 74 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, kërkuesi riparaqiti për shqyrtim kërkesën e tij, në kohën kur u krijuan kushtet për formimin e shumicës së kërkuar.

Pretendimi kryesor i kërkuesit ndaj vendimit të Gjykatës së Lartë qëndron në faktin se në përbërje të trupit gjykues të gjykatës që ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit ka marrë pjesë edhe një gjyqtar, i cili në gjykimin e mëparshëm të po kësaj çështjeje në Gjykatën e Lartë është shprehur me “mendim pakice”, gjë që sipas tij bie në kundërshtim me nenin 72/4 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Kushtetuese çmon se në rastin konkret nuk konstatohet ndonjë shkelje e tillë që mund ta bënte procesin të parregullt në kuptimin e nenit 42 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. E drejta për një proces të rregullt ligjor, si një e drejtë me rëndësi të veçantë kushtetuese, përfshin në vetvete si një nga elementet e saj tepër të rëndësishëm edhe paanshmërinë e gjykatës në gjykimin e çështjes, e cila normalisht nënkuptohet përderisa nuk provohet e kundërta e saj. Në këtë kuadër, Gjykata Kushtetuese çmon se paanshmëria ka elementin e vet subjektiv që i referohet krijimit të bindjes së brendshme të gjyqtarit për çështjen konkrete, si dhe elementin objektiv që nënkupton dhënien nga gjykata të garancive të mjaftueshme për gjykimin e çështjes në mënyrë të paanëshme, duke mënjeluar vetë çdo lloj dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Mes të tjerave, në këtë kuadër, ajo duhet të ketë parasysh sidomos konsideratat me karakter organik që do të thonë mënjanim nga gjykimi i çështjes i atyre gjyqtarëve që

nuk do të ofronin garancitë e nevojshme për paanshmëri. Qëndrimi ndryshe do të bëhej shkak për cenimin e drejtpërdrejtë edhe të parimeve të tjera të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, veçanërisht të parimit të objektivitetit të gjykimit dhe atij të barazisë së armëve. Në shtetin e së drejtës këto kërkesa me rëndësi të veçantë janë në funksion të besimit për dhënien e drejtësisë që duhet të krijojë në çdo rast në shoqërinë demokratike çdo qytetar i thjeshtë.

Parimi i paanshmërisë në gjykim edhe në këndvështrimin e përbërjes së trupit gjykues duhet respektuar në çdo shkallë të gjykimit, pra edhe në gjykimin që zhvillohet në Gjykatën e Lartë.

Megjithatë, Gjykata Kushtetuese çmon se në rastin konkret jemi përpara një situatë tjetër që ndryshon nga ajo që pretendon kërkuesi. Është e vërtetë që në shqyrtimin paraprak të çështjes në fjalë në Dhomën e Këshillimit të Gjykatës së Lartë ka marrë pjesë edhe një gjyqtar, i cili në gjykimin e mëparshëm të po kësaj çështjeje në Gjykatën e Lartë, ku me shumicë është vendosur kthimi për rigjykim në gjykatën e apelit, është shprehur me “mendim pakice”. Por ky fakt, në vështrim të pikës 4 të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, nuk përbën shkak për heqje dorë në mënyrë të detyrueshme në rastin e shqyrtimit të rekursit në Dhomën e Këshillimit. Sipas pikës 4 të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje kur “... ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim...”. Përmbajtja e kësaj dispozite është tepër e qartë, pra bëhet fjalë për rastet kur çështja është në gjykim. Por, a mund të thuhet se shqyrtimi i rekursit në Dhomën e Këshillimit është i njëjtë me gjykimin e çështjes? Për t’i dhënë një përgjigje të saktë ligjore kësaj pyetjeje, duhet nisur nga detyrat që zgjidh Dhoma e Këshillimit dhe detyrat që zgjidh gjykata në seancë gjyqësore. Në Dhomën e Këshillimit trajtohet vetëm prania ose jo e shkaqeve të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile, çka do të thotë që nuk kemi të bëjmë me gjykimin e çështjes në themel. Pikërisht për këto arsye, në këtë fazë, çështja trajtohet jo në seancë publike, pa pjesëmarrjen e palëve ose avokatëve të tyre dhe pa u shpallur data ose përbërja e Dhomës së Këshillimit. Nëse nuk plotësohen kërkesat e nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, në përputhje me nenin 480 të Kodit të Procedurës Civile, Dhoma e Këshillimit vendos mospranimin e rekursit. Në të kundërt pra, nëse konstatohet ndonjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile, vendoset pranimi i rekursit dhe gjykimi i çështjes në kolegji në seancë të rregullt gjyqësore. Natyrisht që këtu çështja trajtohet në themel, pra bëhet kontrolli i plotë i bazueshmërisë në ligj i vendimeve të atakuara në rekurs.

Përsa më sipër, duke pasur parasysh se trajtimi i çështjes në Dhomën e Këshillimit nuk përmban në vetvete të gjitha karakteristikat e një gjykimi në kuptim të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, në rastin konkret nuk mund të pretendohet për shkelje të parimit të paanshmërisë, pra për një proces të parregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese çmon gjithashtu se nga materialet e dosjes nuk rezultojnë të bazuara pretendimet e tjera të kërkuetit që gjykata e apelit nuk ka respektuar detyrat e vëna për këtë çështje nga Gjykata e Lartë dhe se rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë ka qenë brenda kriterëve ligjore, prandaj duhej të ishte pranuar nga kolegji seleksionues. Lidhur me pretendimin e kërkuetit se vendimi i gjykatës së apelit është në kundërshtim me ligjin material, Gjykata Kushtetuese konstaton se ky pretendim nuk përfshihet në konceptin kushtetues të procesit të rregullt ligjor e për rrjedhojë del jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese. Ai i referohet shqyrtimit të çështjes në themel, për të cilën ligjërisht janë të ngarkuara të vendosin gjykatat e sistemit të zakonshëm.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f e 132 të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e 74 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës;
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

## MENDIMI I PAKICËS

Mendimi ynë është i kundërt me qëndrimin që ka mbajtur shumica në zgjidhjen e kësaj çështjeje. Pretendimi kryesor në këtë çështje fokusohet në pjesëmarrjen e një gjyqtari të Gjykatës së Lartë në Dhomën e Këshillimit, ndërkohë që ky gjyqtar në të njëjtën çështje, më parë, kishte arsyetuar gjerësisht me shkrim mendimin e tij në pakicë, duke vlerësuar pabazueshmërinë në ligj dhe në prova të padisë së ngritur nga kërkuesi Agron Vreto.

Në fakt shkelja e parimit të paanësisë në gjykim në këtë çështje bëhet evidente kur konstaton se gjyqtari i Gjykatës së Lartë bën një analizë të hollësishme dhe vlerësim të të gjitha provave që ndodhen në dosje, si dhe shprehet për themelin e çështjes duke arsyetuar përfundimisht se pretendimet e paditësit janë të pasakta, ato nuk qëndrojnë, ai nuk legjitimohet të ngrejë padi dhe padia e tij duhej të rrëzohet.

Në këtë mënyrë me shprehjen e këtij mendimi përfundimtar gjyqtari i Gjykatës së Lartë ia ka kufizuar mundësinë vetvetes të përfshihet përsëri në të ardhmen në të njëjtën çështje dhe të shprehet mbi bazueshmërinë ose jo në ligj të pretendimeve të ngritura në rekurs nga paditësi.

Kur çështja është paraqitur përsëri në Gjykatën e Lartë në përbërje të Kolegjit Civil, në Dhomën e Këshillimit, ka marrë pjesë i njëjti gjyqtar që ka shprehur mendimin e tij për çështjen. Kolegji Civil, në shqyrtim paraprak, ka vendosur moskalimin e çështjes në seancë, sepse nuk janë shkaqet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

Pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë nuk konsiderohet në çdo rast shkelje e parimit të paanësisë në gjykim. Ajo është e ndërruar nga veprimet dhe vullneti që shfaq gjyqtari për çështjen. I vetmi përjashtim bëhet për pjesëmarrjen e gjyqtarëve në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për të cilin Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrim në vendimin nr.15, datë 7.4.2000. Elementet objektive dhe subjektive në një gjykim duhet të jenë të mishëruara në krijimin e besimit tek pala se gjykata do të jetë e paanshme në gjykimin e çështjes.

Në rastin konkret, ne jemi të mendimit se pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar në këtë çështje, ndërkohë që mendimi i tij ishte konkretizuar më parë me arsyetimin me shkrim, nuk mund t'i krijonte besim palës në garantimin e paanësisë së gjykimit. Sipas konkluzionit të arritur nga shumica e Gjykatës Kushtetuese në këtë vendim, nuk është cenuar parimi i paanësisë në gjykim, për arsye se shqyrtimi i çështjes në Dhomën e Këshillimit nuk është i njëjtë dhe duhet dalluar nga gjykimi në seancë gjyqësore. Veçantia që paraqesin këto gjykimeve, sipas shumicës, pavarësisht se gjyqtari ka shprehur mendim mbi thelbin e çështjes, nuk të lejojnë të pretendosh për shkelje të parimit të paanësisë në gjykim. Me këtë qëndrim që ka mbajtur shumica në vendimin e saj jo vetëm që ka një devijim nga jurisprudenca e mëparshme kushtetuese, por afirmohet rishtazi një konkluzion që i krijon hapësirë mosrespektimit të parimit të paanësisë në gjykim në Dhomën e Këshillimit.

Ne mendojmë se është e vërtetë që Dhoma e Këshillimit shqyrton nëse janë paraqitur shkaqe ligjore që bëjnë të mundur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, siç parashikohet në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile, por ky vlerësim që bën gjyqtari realizohet mbi studimin konkret të të dhënave që ndodhen në rekurs e në dosje dhe nuk mund të veçohen nga opinioni ligjor që ai krijon mbi drejtësinë e vendimit gjyqësor.

Gjykata Kushtetuese, në praktikën e saj, ka mbajtur disa herë qëndrime duke konstatuar shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për vendimet që merren në Dhomën e Këshillimit. Këto qëndrime të saj kanë qenë të lidhura me faktin se vendimet e Dhomës së Këshillimit janë po aq të rëndësishme sa edhe ato të seancës gjyqësore, dhe jo të asaj natyre që i trajton shumica në vendim. Vendimet e marra në Dhomën e Këshillimit nuk përjashtohen nga kontrolli i kushtetutshmërisë së tyre.

Në këto kushte, parimi i paanësisë në gjykim është një ndër parimet që nuk mund të kufizohet qoftë edhe për arsye të rrethanave të ndryshme. Përderisa në Dhomën e Këshillimit mbledhet një kolegji që merr një vendim gjyqësor dhe që i jep zgjidhje përfundimisht çështjes, atëherë ajo nuk përjashtohet nga detyrimi për të respektuar paanësinë në gjykim. Mbi bazën e kësaj logjike arsyetimi, Gjykata Kushtetuese ka theksuar në jurisprudencën e saj, garancinë që u jep palëve në gjykim mospjesëmarrja në kolegjet seleksionuese të gjyqtarëve që kanë gjykuar më parë çështjen, duke e konsideruar këtë fakt si “element i rëndësishëm ligjor, që i shërben garantimit të zhvillimit normal të një gjykimi të rregullt dhe të paanshëm”.

A N Ë T A R

K. Puto S. Sadushi

**V E N D I M**  
**Nr.17, datë 8.5.2003**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Zija Vuci Anëtar i “““

Gjergj Sauli Anëtar i “““

Alfred Karamuço Anëtar i “““

Kujtim Puto Anëtar i “““

Petrit Plloçi Anëtar i “““

Sokol Sadushi Anëtar i “““

Kristofor Peçi Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 2.12.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.212/5 Akti që i përket:

**KËRKUES: AVOKAT SELIM CAKA**

**SUBJEKTI I INTERESUAR: PROKURORI I PËRGJITHSHËM, në mungesë.**

**OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.142, datë 26.2.2002 të Kolegjit**

Penal të Gjykatës së Lartë

**BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.**

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të mësipërm:

- Vendimi bie ndesh me parimet kushtetuese dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, që rregullojnë të drejtat e mbrojtësit në procesin penal;

- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit për shkak moslegjitimiti, ka cenuar parimet kushtetuese të mbrojtjes dhe të procesit të rregullt ligjor, të parashikuara nga nenet 31/c e 42 të Kushtetutës;

- Akti i përfaqësimit është bërë në përputhje të plotë me kërkesat e neneve 48 e 410/2 të Kodit të Procedurës Penale dhe gëzon të gjitha të drejtat e mbrojtësit në një mbrojtje të detyrueshme, përfshirë edhe të drejtën e ankimit ndaj vendimit të gjykatës.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, kërkuesin dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin objekt kërkesë ka vendosur mospranimin e rekursit të mbrojtësit të të pandehurit Dashnor Mark Prenga, me arsyetimin se nuk është paraqitur në mënyrën dhe formën e parashikuar nga nenet 410 dhe 435 të Kodit të Procedurës Penale.

Kërkuesi, me cilësinë e avokatit mbrojtës, parashtron se ka qenë i pajisur me një prokurë të bërë me akt noterial dhe të lëshuar nga vëllai i të gjykuarit, sipas kërkesave të neneve 48 dhe 410/2 të Kodit të Procedurës Penale dhe në këto kushte, ka gëzuar të drejtën për të ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës, dhënë në mungesë të të pandehurit. Ai shprehet se duke iu mohuar e drejta e ankimit i është mohuar të pandehurit e drejta e mbrojtjes, prandaj procesi gjyqësor është i parregullt.

Gjykata Kushtetuese çmon se kërkesa është e bazuar dhe duhet të pranohet. Kolegji Penal i

Gjykatës së Lartë, duke i mohuar mbrojtësit të drejtën e ankimit ndaj vendimit të gjykatës dhënë në mungesë të të pandehurit, nuk i ka dhënë mundësi këtij të fundit të ushtrojë të drejtën kushtetuese të mbrojtjes, gjë që e bën procesin gjyqësor të parregullt. Mbrojtësi i të pandehurit që gjykohet në mungesë, i caktuar sipas kërkesave të nenit 48 të Kodit të Procedurës Penale, gëzon të gjitha të drejtat e mbrojtësit si në një mbrojtje të detyrueshme, përfshirë edhe të drejtën e ankimit ndaj vendimit të gjykatës. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ia ka mohuar mbrojtësit këtë të drejtë në një kohë, kur ligji ia garanton atë plotësisht. Çështja penale është shqyrtuar në Gjykatën e Lartë në datë 26.2.2002, pra, para ndryshimit të nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale të bërë me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002. Sipas kësaj dispozite, mbrojtësi i të pandehurit të gjykuar në mungesë gëzon të drejtën e ankimit ndaj vendimit të gjykatës, kur ai është i pajisur me aktpërfaqësimi të lëshuar sipas ligjit. Duke iu referuar neneve 48 e 410/2 të Kodit të Procedurës Penale, rezulton se kërkuksi i plotësonte këto kritere ligjore, sepse ka qenë i pajisur me aktpërfaqësimi të lëshuar nga vëllai i të pandehurit. Këtë qëndrim ka mbajtur dhe Gjykata Kushtetuese në dy vendimet e saj, të cilat kanë hyrë në fuqi para gjykimit të kësaj çështjeje dhe detyrimisht duhej të zbatoheshin nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Kështu, me vendimet nr.17, datë 17.4.2000 dhe nr.5, datë 7.2.2001, Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr.386, datë 29.7.1999 dhe nr.371, datë 21.10.2000 për shkelje të së drejtës kushtetuese të mbrojtjes në procesin penal. Në këto vendime, Gjykata Kushtetuese, duke interpretuar përmbajtjen e neneve 410/2 e 48 të Kodit të Procedurës Penale, në përputhje me Kushtetutën, Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe aktet e tjera ndërkombëtare, u ka dhënë këtyre dispozitave një kuptim të caktuar për të garantuar të drejtën e mbrojtjes si një e drejtë kushtetuese.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke mos pranuar për shqyrtim ankimin e bërë nga kërkuksi si mbrojtës i të pandehurit në mungesë, i ka mohuar të pandehurit të drejtën e mbrojtjes, gjë që e bën procesin të parregullt dhe vendimin antikushtetues.

Gjykata Kushtetuese thekson se e drejta e mbrojtjes në procesin penal duhet të garantohet dhe të realizohet në mënyrë efektive. Edhe në rast se i akuzuari nuk pranon të marrë pjesë vetë në gjykim ose t'i fshihet drejtësisë, atij duhet t'i garantohet e drejta për t'u mbrojtur me avokat në çdo shkallë të gjykimit. Kjo është në interes të bërjes së drejtësisë duke respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor. Në të kundërtën, shkelja e këtyre parimeve do të kompromentonte vetë drejtësinë.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me shumicë votash,

#### V E N D O S I:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.142, datë 26.2.2002 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë;
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë;
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

#### **SHPLLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM**

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim publik të pasurive të paluajtshme për ndërtimin e segmentit rrugor Valias-Qerekë-Rinas, si dhe të pronarëve që ndodhen brenda rrethimit të Aeroportit "Nënë Tereza".

Subjekti kërkuks i këtij shpronësimi është "Sh.a. Albtransport".

Republika e Shqipërisë  
Qarku Tiranë  
Fshati: Qerekë-Rinas

Lista e pronarëve që shpronësohen për efekt të ndërtimit të rrugës Valias-Qerekë-Rinas si dhe të pronarëve që ndodhen brenda rrethimit të Aeroportit “Nënë Tereza”

Lloji i pasurisë së paluajtshme: Tokë bujqësore, truall, kullotë nr.1-40

| Nr | Emri     | Atësia  | Mbiemri | Nr. pasurisë | Tokë Bujqësore m2 | Truall Sip. m2 | Kullotë Sip.m2 | Çmimi Lek/m2 | Vlera (Lek) | Shënime                 |
|----|----------|---------|---------|--------------|-------------------|----------------|----------------|--------------|-------------|-------------------------|
| 1  | Abedin   |         | Kala    | 146/13       | 100               |                |                | 1000         | 100000      | Plotësim dokumentacioni |
| 2  | Sherif   |         | Kallari | 146/34       | 700               |                |                | 1000         | 700000      | Plotësim dokumentacioni |
| 3  | Besim    |         | Kallari | 146/32       | 460               |                |                | 1000         | 460000      | Plotësim dokumentacioni |
| 4  | Qamil    | Lule    | Kallari | 146/30       | 403               |                |                | 1000         | 403000      | Plotësim dokumentacioni |
| 5  | Mehdi    | Kallari |         | 146/28       | 288               |                |                | 1000         | 288000      | Plotësim dokumentacioni |
| 6  | Ramazan  |         | Kallari | 146/28       | 300               |                |                | 1000         | 300000      | Plotësim dokumentacioni |
| 7  | Shkëlqim |         | Kallari | 146/24       | 113               |                |                | 1000         | 113000      | Plotësim dokumentacioni |
| 8  | Beram    |         | Kallari | 146/22       | 213               |                |                | 1000         | 213000      | Plotësim dokumentacioni |
| 9  | Esat     |         | Kallari | 146/20       | 288               |                |                | 1000         | 288000      | Plotësim dokumentacioni |
| 10 | Petrit   |         | Kallari | 146/18       | 125               |                |                | 1000         | 125000      | Plotësim dokumentacioni |
| 11 | Hysen    |         | Kallari | 146/16       | 350               |                |                | 1000         | 350000      | Plotësim dokumentacioni |
| 12 | Kujtim   |         | Kallari | 140/21       | 495               |                |                | 1000         | 495000      | Plotësim dokumentacioni |
| 13 | Petrit   | Kallari |         | 140/19       | 190               |                |                | 1000         | 190000      | Plotësim dokumentacioni |
| 14 | Ramazan  |         | Halili  | 140/17       | 520               |                |                | 1000         | 520000      | Plotësim dokumentacioni |
| 15 | Xhemal   |         | Sula    | 140/15       | 357               |                |                | 1000         | 357000      | Plotësim dokumentacioni |
| 16 | Haxhi    |         | Sula    | 140/13       | 674               |                |                | 1000         | 674000      | Plotësim dokumentacioni |
| 17 | Fiqiri   |         | Sula    | 140/11       | 925               |                |                | 1000         | 925000      | Plotësim dokumentacioni |
| 18 | Xhelal   |         | Sula    | 49/27        | 645               |                |                | 1000         | 645000      | Plotësim dokumentacioni |
| 19 | Petrit   |         | Sula    | 59/29        | 555               |                |                | 1000         | 555000      | Plotësim dokumentacioni |
| 20 | Ram      |         | Doku    | 59/31        | 100               |                |                | 1000         | 100000      | Plotësim dokumentacioni |
| 21 | Naim     |         | Doku    | 59/33        | 432               |                |                | 1000         | 432000      | Plotësim dokumentacioni |
| 22 | Bedri    |         | Maloku  | 59/34        | 390               |                |                | 1000         | 390000      | Plotësim dokumentacioni |
| 23 | Mersin   |         | Kurti   | 59/39        | 323               |                |                | 1000         | 323000      | Plotësim dokumentacioni |

|    |         |        |         |          |        |       |       |      |          |                         |
|----|---------|--------|---------|----------|--------|-------|-------|------|----------|-------------------------|
| 24 | Skënder |        | Cekelli | 59/41    | 133    |       |       | 1000 | 133000   | Plotësim dokumentacioni |
| 25 | Musa    |        | Zhllima | 59/43    | 405    |       |       | 1000 | 405000   | Plotësim dokumentacioni |
| 26 | Etem    |        | Zhllima | 59/43    | 338    |       |       | 1000 | 338000   | Plotësim dokumentacioni |
| 27 | Xhavit  |        | Kallari | 59/47    | 100    |       |       | 1000 | 100000   | Plotësim dokumentacioni |
| 28 | Ramazan |        | Balliu  | 59/49    | 300    |       |       | 1000 | 300000   | Plotësim dokumentacioni |
| 29 | Hider   |        | Balliu  | 59/51    | 440    |       |       | 1000 | 440000   | Plotësim dokumentacioni |
| 30 | Hamid   |        | Balliu  | 59/53-10 | 1100   |       |       | 1000 | 1100000  | Plotësim dokumentacioni |
| 31 | Sami    |        | Doku    | 59/35    | 375    |       |       | 1000 | 375000   | Plotësim dokumentacioni |
| 32 | Abdylla | Zenel  | Kulla   | 147/9    |        |       | 1045  | 300  | 313500   |                         |
| 33 | Avdulla | Zenel  | Kulla   | 146/13   |        |       | 700   | 300  | 210000   |                         |
| 34 | Avdulla | Zenel  | Kulla   | 149      |        |       | 5561  | 300  | 1668300  |                         |
| 35 | Zenel   | Berush | Kulla   | 34/3     |        | 1200  |       | 1500 | 1800000  |                         |
| 36 | Ali     | Xhemal | Kurti   | 148/2    | 2000   |       |       | 1000 | 2000000  |                         |
| 37 | Abdylla | Zenel  | Kulla   | 148/1    |        | 4400  |       | 1500 | 6600000  |                         |
| 38 | Halim   |        | Leka    | 217/1    |        | 5000  |       | 1500 | 7500000  |                         |
| 39 | Halim   |        | Leka    | 150/7    |        |       | 5568  | 300  | 1670400  |                         |
| 40 | Halim   |        | Leka    |          |        |       | 1900  | 300  | 570000   |                         |
|    | Shuma:  |        |         |          | 141137 | 10600 | 14774 |      | 34469200 |                         |

Mbyllet me numër rendor 40 (dyzet)

Shënim: Brenda afatit ligjor 15 ditë pas publikimit të gjithë pronarët që janë me shënimin “Plotësim dokumenti” paraqesin dokumentacionin e nevojshëm ligjor (certifikatë pronësie, hartë treguese) të noterizuara, pranë sektorit të shpronësimeve në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.

### SHPALLJE KËRKESË PËR SHPRONËSIM

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim publik të pasurive të paluajtshme për rehabilitimin e Urës së Bënçës Tepelenë, në territorin e qarkut Gjirokastrë. Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve.

Republika e Shqipërisë  
Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit  
Drejtoria Juridike

Lista e pronarit që shpronësohet nga rehabilitimi i Urës së Bënçës, Tepelenë

| Nr | Emri  | Atësia  | Mbiemri | Numri i pasurisë | Truall           |               |            | Shënime                 |
|----|-------|---------|---------|------------------|------------------|---------------|------------|-------------------------|
|    |       |         |         |                  | Sip.shpronës. m2 | Çmimi lekë/m2 | Vlera lekë |                         |
| 1  | Agron | Ramadan | Hasa    | 3.47             | 866              | 2000          | 17320000   | Plotësim dokumentacioni |

Mbyllet me numër rendor 1 (një)

Shënim: Brenda afatit ligjor 15 ditë pas publikimit, pronari të paraqesë dokumentacionin e

nevojshëm ligjor (certifikatë, hartë treguese dhe kartelë) të noterizuara, pranë sektorit të shpronësimeve në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.

**Fletorja Zyrtare gjendet:**

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
  - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

|                                                                                                            |                                                                                                                                                   |                                                                                                                  |                                                                                                  |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Kodi Penal</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Mars, 2002               | <b>Kodi i<br/>Procedurës Penale</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Shtator, 2002                                 | <b>Kodi i<br/>Procedurës Civile</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Korrik, 2002 | <b>Kodi Rrugor</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Qershor, 2002 |
| <b>Kodi Penal<br/>Ushtarak</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Tetor, 2002 | <b>Përmbledhëse<br/>legjislacioni<br/>në fushën<br/>e Përmbarimit</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Tetor, 2002 |                                                                                                                  |                                                                                                  |

Doli nga shtypi më 28.5.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë